

V E N D I M
Nr.67, datë 12.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli,	Anëtar i “““
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““
Tefta Zaka,	Anëtar i “““
Petrit Plloçi,	Anëtar i “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, më datë 12.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.94 Akti që i përket:

KËRKUES: ZIHNI BEQIRAJ, kandidat për deputet në zonën zgjedhore nr.27, përfaqësuar me deklaram nga avokat Nikolla Kondakçi.

SUBJEKTE TË INTERESUAR:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.
2. PËLLUMB BERISHA, përfaqësuar me deklaram nga avokat Halil Kopani.
3. KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.27, përfaqësohet nga Mehmet Berisha, kryetar.

O B J E K T I:

Pavlefshmëria e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për zonën zgjedhore nr.27.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjo i relatorin e çështjes Kristofor Peçi, kërkuesin dhe përfaqësuesin e tij, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Komisioni i Zonës Zgjedhore nr.27, me vendimin nr.008, datë 26.6.2001 ka shpallur deputet të drejtpërdrejtë të zonës zotin Pëllumb Berisha, përfaqësues i subjektit zgjedhor “Bashkimi për Fitore”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.927, datë 28.6.2001 ka vendosur shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve në zonën nr.27, duke njohur si fitues kandidatin Pëllumb Berisha.

Në kërkesën e tij për pavlefshmëri të rezultatit përfundimtar, kërkuesi Zihni Beqiraj pretendon se gjatë procesit zgjedhor janë kryer shkelje në lidhje me formimin e komisioneve të qendrave të votimit dhe atij të zonës, votime nga kryefamiljarët për llogari të personave të tjerë, mosrakordim të të dhënave në tabelën e rezultateve për disa qendra votimi, marrjen e dokumentacionit nga Komisioni i Zonës Zgjedhore pa i kontrolluar sipas ligjit dhe mospasqyrim të gjendjes reale në tabelat e rezultatit të votimit.

Gjykata Kushtetuese çmon se pretendimet e kërkuesit për formimin e komisioneve të qendrave të votimit dhe atij të zonës, nuk mund të merren në shqyrtim për faktin se për to është bërë ankim sipas ligjit në Gjykatën e Apelit, e cila e ka zgjidhur çështjen përfundimisht.

Përsa i përket pretendimeve të tjera, ato janë të karakterit të përgjithshëm, të pambështetura në prova dhe pa argumentuar ndikimin e shkeljeve në rezultatit të votimit. Por, më i rëndësishëm është fakti se për këto shkelje për të cilat pretendohet pavlefshmëria e zgjedhjeve, kërkuesi nuk ka paraqitur fare ankim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese, e cila sipas nenit 141 të Kodit Zgjedhor shqyrton ankimet kundër vendimeve të Komisionit Qendror të

Zgjedhjeve, nuk mund ta shqyrtojë këtë çështje.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 të Kushtetutës nenit 141 të Kodit Zgjedhor, si dhe neneve 67 e 72 të Ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.